

**AKT THEMELIMI DHE STATUTI I
SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR
“Digital Cranes” Sh.p.k**

**KAPITULLI I-re
Themelimi, Emërtimi, Selia, Kohëzgjatja, Objekti,
Organizimit dhe Funksionimi**

Sot më datë 10 Shkurt 2023, duke u bazuar në Ligjin Nr.9901, datë 14.04.2008, "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare" i ndryshuar, si dhe në Ligjin Nr.9723, datë 03.05.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit" i ndryshuar, ne të nënshkruarit shprehim vullnetin tonë të lirë dhe të plotë, për të nënshkruar këtë statut dhe akt themelimi me qëllim krijimin e shoqërisë "Digital Cranes" Sh.p.k- si më poshtë vijon:

NENI 1

Sot më datë 14 Shkurt 2023, duke u bazuar në Ligjin Nr.9901, datë 14.04.2008, "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare" i ndryshuar, si dhe në Ligjin Nr.9723, datë 03.05.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit" i ndryshuar, ne të nënshkruarit shprehim vullnetin tonë të lirë dhe të plotë, për të nënshkruar këtë statut dhe akt themelimi me qëllim krijimin e shoqërisë "Digital Cranes" Sh.p.k - si më poshtë vijon:

Elton Pllaha i biri i Bashkimit i lindur në 20/11/1983 në Guras, Pogradec banues në Tiranë me dokument identifikim ID I31120017K | Nr. Letërnjoftimi 033901820

Oraldo Hoxhallari i biri i Besimit i lindur ne Tirane, me 01/12/1994 me dokument identifikim ID J41201069C | Nr Pasaportë B1482305


Të cilët kanë vendosur krijimin e shoqërisë "**Digital Cranes**" Sh.p.k dhe miratimin e statutit të shoqërisë në bazë të legjislacionit në fuqi të Republikës së Shqipërisë veçanërisht sipas Ligjit 9901 dt 14.04.2008, "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare" i ndryshuar dhe si person juridik të zhvillojnë aktivitetin në përputhje me legjislacionin Shqiptar në fuqi dhe me normat e këtij statuti. Ky statut hyn në fuqi pas regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Biznesit.

NENI 2 – SELIA

Selia e shoqërisë tregtare private "**Digital Cranes**" Shpk do te këtë selinë ne: Rr. Bulevardi Migjeni, Tiranë, Shqipëri .

NENI 3- KOHEZGJATJA

Kohëzgjatja e shoqërisë është me kohe te pacaktuar, dhe mund te shtyhet ose te mbyllet me pare me vendimin e Asamblesë Ortakeve. që është i vlefshëm me shumicën e dy te tretës se kapitalit shoqëror.



NENI 4- OBJEKTI

Zhvillim software në të gjitha platformat për web, desktop, mobile etj. duke përfshirë proceset e analizës ,projektim, planifikim, implementim, mirëmbajtje brenda dhe jashtë territorit të Shqipërisë.

Zhvillim ose ndërmjetësim në trajnime dhe kurse profesionale në fushën e zhvillimit të software dhe TI (Teknologjisë së Informacionit). brenda dhe jashtë territorit të Shqipërisë Konsulencë në fushën e zhvillimit software në platforma të ndryshme. Projektim software-i. Këtu përfshihet analiza e kërkesave të sistemit software, projektimi i arkitekturës dhe projektimi i detajuar i sistemit software;

Zhvillim dhe mirëmbajtjen sistemesh software. Këtu përfshihet programimi i sistemeve software, kodimi, instalimi, integrimi i të gjithë komponentëve, dokumentimi, identifikimi dhe korrigjimi i gabimeve, modifikimet (pas momentit që software-i është vendosur në punë), mirëmbajtja e të gjithë komponentëve, mbështetja dhe mirëmbajtja e sistemit si një tërësi komponentësh, që në funksionimin e tyre realizojnë qëllimin e zgjidhjes informatike;

Testim software. Këtu përfshihet testimi i funksionaliteteve, të ngarkesës në punë, të performancës, të pranimit, të disponueshmërisë dhe të sigurisë së sistemit software;

Projektim dhe zhvillim sistemesh të komunikimit. Këtu përfshihet analiza, planifikimi, projektimi, zbatimi, vendosja në punë dhe mirëmbajtja e sistemeve të komunikimit të rrjeteve të pajisjeve informatike (LAN/ WAN/ WLAN/ MAN/ SAN/ CAN);

Projektim dhe zhvillim sistemesh të sigurisë. Këtu përfshihet analiza e kërkesave të sigurisë së klientit, projektimi i arkitekturës, instalimet dhe konfigurimet e komponentëve, vendosja në punë, testimet e sigurisë dhe mirëmbajtja përkatëse

Zhvillim sistemesh migrimi. Këtu përfshihet transferimi i të dhënave dhe infrastrukturës përkatëse nga një teknologji e vjetër në një teknologji të re; Përmirësim/upgrade sistemesh informatike; Operimi, menaxhimi, mbështetja e përdorimit, trajnimi dhe auditimi teknik/ informatikë për sistemet software.

Konsulentë me fushatat e marketingut digjital edhe analog ku përfshihet, krijimi i reklamave dhe administrimi i rrjeteve sociale të individëve edhe shoqërive tregtare.

Zhvillime dhe projekte instalimi i sistemeve të Inteligjencës Artificiale.

Ofrimi, marrja dhe ndërmjetësimi i shërbimeve për dhe nga të tretë i shërbimeve mbështetëse në fushën e kontabilitetit, marketingut dhe konsulencës administrative, këtu përfshihen

konsulenanca për praktikën dhe çështjet doganore, për mbajtjen e kontabilitetit dhe llogarive financiare si dhe dokumenteve Financiare dhe Fiskale, juridike të shoqërive dhe individëve!

Ofrimi, marrja dhe ndërmjetësimi i shërbimeve për dhe nga të tretë i shërbimeve mbështetëse Projektimit, ndërtimit, testimit dhe mbështetjes të programeve, faqeve të internetit sistemeve të informative, aplikacioneve në të gjitha sistemet operative në distancë (Remote) brenda dhe jashtë territorit të Shqipërisë

Shitja dhe blerja e mallrave me shumicë dhe pakica brenda dhe jashtë territorit të Shqipërisë, Importi dhe Eksporti i mallrave të ndryshëm, Stampimi i bluzave dhe veshjeve të personalizuar, Përdorimi i Makinerive termike dhe jo termike, për stampimin e veshjeve dhe logove të ndryshme, edhe objekteve të ndryshme të personalizuar!

Import-Eksport, tregti me shumicë e pakica i pajisjeve teknologjike, telekomunikacioni, kompjuterike etj. Grumbullim të dhënash dhe statistika (sondazhe, testim tregu, reklamim telefonik) etj.

Konsulencë, ndërmjetësim shitje primesh në fushën e sigurimeve të pronave, automjeteve, siguracioneve të jetës, shëndetit edhe etj.

KAPITULLI II KAPITALI SHOQEROR- KUOTAT

NENI 5 - KAPITALI SHOQEROR

Kapitali fillestar i shoqërisë private “**Digital Cranes**” Sh.p.k do te jete 10.000 (dhjete mije leke) tërësisht i shlyer nga ortakët para regjistrimit te. Pjesëmarrja e themeluesve në kapitalin e shoqërisë është në përputhje me kontributet e tyre të mëposhtme:

Ortaku Themelues **Elton Pllaha** Zotërues i 1 (një) kuote me vlerë të përgjithshme 7000 (Shtate mijë) Lekë që përben 70% të kapitalit themeltar të shoqërisë.

Ortaku Themelues **Oraldo Hoxhallari** Zotërues i 1 (një) kuote me vlerë të përgjithshme 3000 (Tre mijë) Lekë që përben 30% të kapitalit themeltar të shoqërisë.

Kontributi i ortakëve mund të jetë në para ose në natyrë (pasuri të luajtshme/të paluajtshme apo të drejta)Kapitali themeltar fillestar mund të shtohet ose të pakësohet (por jo nën vlerën e kapitalit themeltar fillestar).Kapitali shoqërisë mund rritet ose zvogëlohet me miratimin unanimitet të ortakëve. Asambleja mund të vendose zvogëlimin e kapitalit shoqëror nëpërmjet të shitjes ose grupeve me veprimtari të caktuar shoqërore, ose si aksione ose si kuota për ndërmarrjet e tjera ne te cilat shoqëria është pjesëmarrëse. Rritja e kapitalit shoqëror mund te nënshkruhet e te derdhet edhe nga të tretët.

NENI 6- KUOTAT

Kapitali Shoqëror është i ndare ne kuota qe mund te jene te shumave te ndryshme. Kuotat janë te gjitha nominativë. Dhënia te tretëve është e lejuar vetëm me miratimin e Asamblesë se Ortakeve, qe me unanimitet do te përcaktojë kohet dhe mënyrat e transferimit.

NENI -7

Shoqëria ka te drejte gjithashtu te hape linja krediti, hua direkt e indirekte te fraksionuara, nëpërmjet instituteve financiare kombëtare e ndërkombëtare, duke dhënë garanci reale përkundrejt financimeve. Te xhiroje dhe te emetoje tituj - me afate, te japë dorëzani dhe garanci te çdo tipi, reale ose personale. Pjesëmarrje përmes blerjes se aksioneve ose formave te tjera, direkt ose indirekte ne shoqëri te tjera.

Te kryeje gjithë operacionet e mundshme te lokacioneve financiare te natyrës pasive, arkëtime e pagesa tete gjithë llojeve dhe ne te gjithë tipit e valutave. Mund te kryeje shërbime te kërkimeve te tregut, te analizave financiare dhe ekonomike, te statistikave, te studimeve organizative dhe te impianteve, te iniciativave industriale dhe tregtare.

NENI – 8

Ne rast kur një ortak dëshiron te japë dorëheqjen nga kuota e tij e kapitalit shoqëror -me përjashtim te lënies trashëgimtareve - ortakët e tjerë kane te drejtën e marrjes se saj. secili me një sasi te përpyesshme me kuotën qe zotëron. Ortaku qe largohet duhet te njoftoje ortakët e tjerë me letër rekomande me përgjigje, nëpërmjet organit ekzekutiv, duke përcaktuar çmimin dhe kushtet e shitjes.

Ne qofte se brenda 30 ditëve te marrjes se njoftimit, ortakët e njoftuar nuk dërgojnë përgjigjen e marrjes me letër rekomande, duke njoftuar vendimin e tyre për te drejtën e blerjes, ortaku ofrues është i lire te shesë kuotën e tij te trentëve, me kushtet e treguara ne oferte ose me kushte me te renda. Ne rastin kur një ortak i vetëm vendos te blere gjithë paketën e kuotës shoqërore ne shitje, kur gjithë ortakët e tjerë e refuzojnë, do ti jepet shitja ortak ut te interesuar.



NENI – 9

Ne rast vdekje te një ortaku, shoqëria vazhdon me trashëgimtarin ligjor te trashëgimlënësit. Ne rastin e disa trashëgimtareve ligjore duhet te njoftohet brenda 6 muajve te vdekjes, se kush prej tyre do te konsiderohet ortaku ose qe do ti përfaqësojë ndaj shoqërisë.

NENI -10

Transferimi i kuotave shoqërore ka efekt ne raport me shoqërinë, vetëm ne momentin e regjistrimit ne librin e ortakeve. Ky regjistrim mund te behet vetëm me kërkesën e blerësit ose te shitësit, me tregimin e mandatit ku rezulton transferimi, ose përmes deklaratës ne librin e ortakeve te nënshkruar nga shitësi dhe blerësi e te kundërfimosura nga avokati përfaqësues i shoqërisë.

KAPITULL III ASAMBLETE

NENI 11- ASAMBLEJA E ORTAKEVE

Asambleja e Ortakeve (AO) përfaqëson universitetin e ortakeve dhe vendimet e tyre. te mara me unanimitet dhe konfrom ligjeve dhe këtij Statuti.

Asambleja është e zakonshme dhe e jashtëzakonshme sipas ligjit.

NENI - 12

Asambleja thirret me letër rekomande, qe u dërgohet ortakeve te paktën tete dite para mbledhjes, ne adresën qe rezulton nga libri i ortakeve.

Asambleja mund te quhet e mbledhur edhe ne mungese te këtij formaliteti, mjafton qe te jete i pranishëm dhe i përfaqësuar krejt kapitali shoqëror dhe Organi Administrativ. Asambleja mund te mblidhet edhe jashtë selis se shoqërisë.

NENI - 13

Asambleja e zakonshme duhet te mblidhet te paktën një here ne vit, brenda 6 muajve nga mbyllja e veprimtarisë për miratimin e bilancit dhe destinacionin e fitimeve. Asambleja mblidhet për te marre vendime te kompetencës se vet, kur administratori e konsideron te përshtatshme. Thirrja e Asamblesë duhet te behet gjithashtu pa vonese kur është bere kërkesë e ligjshme.

NENI - 14

Kane te drejte te marrin pjese ne Asamble ortaket qe rezultojnë te regjistruar ne librin e ortakeve te paktën pese dite para asaj te fiksuar për Asamblenë.

Çdo ortak mund te përfaqësohet nëpërmjet delegimit me shkrim, nga persona jo administratore dhe jo nëpunës te shoqërisë.



NENI - 15

Asambleja kryesohet nga Administratori dhe ne mungese, nga person i zgjedhur nga Asambleja dhe ky emëron një sekretar qofte dhe jo ortak. Ne Asambletë e jashtëzakonshme dhe kur quhet e përshtatshme, procesverbali redaktohet nga një noter.

NENI - 16

Asambleja e zakonshme quhet e rregullt me praninë e aq ortakeve, qe përfaqësojnë veten ose medelegim, te paktën dy te tretat kapitalit shoqëror.

Ajo merr vendime te vlefshme me votën e favorshme te shumicës absolute te kapitalit shoqëror. Asambleja e asambleja e jashtëzakonshme quhet e rregullt me praninë e ortakeve, qe përfaqësojnë veten ose me delegim, te paktën dy te tretat e kapitalit shoqëror. Ajo merr vendime te vlefshme me votën e favorshme te dy te tretave te kapitalit shoqëror.

Votat ne çdo rast llogariten ne çdo mije Leke te kapitalit shoqëror.

NENI - 17

Vendimet e Asamblesë duhet te dokumentohen duke u nënshkruar nga Presidenti dhe nga Sekretari ose Noteri.

Ne verbal duhet te përfshihen, me kërkesë te ortakeve, deklarimet e tyre.

NENI - 18

Vendimet Asamblesë te mara konform me ligjet dhe Statutin e shoqërisë , lidhin gjithë ortakët edhe pse nuk kane folur ose kane munguar. Kundërshtimet eventuale te vendimeve duhet te paraqiten ne përputhje me ligjet.

KAPITULLI IV

ADMINISTRIMI

NENI - 19


Shoqëria administrohet nga një Administrator i vetëm Elton Pllaha duke filluar nga themelimi i shoqërisë për një periudhe 5 vjeçare.

NENI - 20

Administratori i Vetëm është i pajisur me fuqi te plote për administrim duke i konsideruar te tilla gjithë aktet e nevojshme dhe te përshtatshme për zhvillimin normal te veprimtarisë prodhuese.

Për aktet e jashtëzakonshme te administrimit, kërkohet autorizimi paraprak i Asamblesë se Ortakëve.

Administratorit të vetëm i takon firma e shoqërisë dhe përfaqësimi ligjor i shoqërisë ne raport me te trete dhe ne gjykim te çfarëdolloj gjeje e ne çfarëdolloj shkalle. Administratori i vetëm mund te emëroje drejtore dhe prokuratorë speciale për akte te caktuara dhe kategori aktesh, duke përjashtuar ato qe ligji, Asambleja dhe Statuti i shoqërisë i kërkon Administratorit te vetëm.



KAPITULLI V BILANCI DHE TATIMET

NENI - 21

Veprimtaria e shoqërisë mbyllet me 31 Dhjetor të çdo viti. Në fund të çdo veprimtarie do të përpilohet, nën kujdesin e Administratorit të Vetëm, bilanci që do të paraqitet Asamblesë për miratim, brenda afatit prej maksimumi 6 muaj. Fitimet neto, pas zbritjes së shumës së parashikuar nga Kodit Civil, për formimin e një fondi rezerve dhe lënive të tjera mënjane me ligj deri në arritjen e kufirit që kërkohet nga ligji, do të destinohen here pas here sipas vendimeve të Asamblesë Ortakeve, që mund edhe të përcaktojnë një shpërndarje të fitimeve ortakeve të pakicës mbi kuotën e kapitalit të derdhur.

KAPITULLI VI LIKUJDIMI

NENI - 22

Duke qenë e detyruar për çdo lloj arsye dhe në çfarëdo kohe, për prishjen e shoqërisë, Asambleja përcakton mënyrat e likuidimit dhe do të emërojë një ose disa likuidatorë, duke përcaktuar fuqinë dhe kompensimin.

NENI - 23

Përveç kompetencës së paapelueshme të Autoriteteve Gjyqësore, mosmarrëveshjet që mund të lindin midis shoqërisë dhe ortakeve në varësi të këtij statuti, do të vendosen me konsensus unanim ose në favor të paktën të njëjës pale në grindje, nga një Kolegj Arbitrash i formuar nga tre arbitra të emëruar nga dy palët, një nga secila dhe i treti në akord midis palëve dhe me rakordomin e Kryetarit të Gjykatës.

Kolegji arbitral do të vendosë me shumicë, pa formalitete procedurale me vendim të paapelueshme, Secila pale do të përballojë shpenzimet e arbitrit të vet dhe gjysmat e të tredit.

NENI - 24


Për çka nuk është parashikuar në këtë Statut dhe nga Akti i Themelimit, vlejnë dispozitat përkatëse në fuqi.

Ky statut u redaktua në gjuhën shqipe në tre kopje, dhe përben dokumentin themelor dhe operativ të shoqërisë.

“Digital Cranes” Sh.p.k

ORTAKET

Elton PLLAHA



Oraldo HOXHALLARI

Oraldo Hoxhallari

